

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim me ushqime

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Mish vici dhe produkte nga mishi i vicit-15131600-1; qumeht- 15511000-3; veze-03142500-3; buke-15811100-7; miell gruri-15612100-7; perime me fruta-03221200-8; sheqer-15831000-2;**

VLERA E FONDIT LIMIT: 8 195 600 (tetemilion njeqind e nentdhjete e pese mije e gjashteqind) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: a.
2. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
3. b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vlerësimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, Kodi II.1.A(1) Prodhim, perpunim shpërndarje me shumice e ushqimeve për njëzë.

- Liçencë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit, Kodi II.1.B, Shitje me shumice e ushqimeve me origjinë shtazore (për njëzë).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/ a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; VKM nr.539, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendres Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të përbashkëta” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimeve, objekt i kontratës, të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, leshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Sipas nenit 43 pika 2/b të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet “sa vlera e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar” Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetimi i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Vërtetim për numrin mesatar të punonjësve për periudhën kohore 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, jo më i vogël se 5 punonjës, i vërtetuar nga organet tatimore për të mundësuar realizimin e kontratës me sukses, ndër të cilët 2 shofera dhe 2 punëtorë krahu të pasqyruara në listëpagesa me kodin përkatës.

Në lidhje me këto pike të paraqitjes: Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar si dhe listëpagesat për secilin muaj.

Disponimi i punonjësve si më sipër do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të leshuara nga institucionet përkatëse të akredituara nga DPA:

1. ISO 22000:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë së ushqimore, e vlefshme)
2. ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Ofertuesi te paraqesë:

1- Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale me sipërfaqe totale jo me pak se 50 m² dhe ku ambjenti frigoriferik jo me pak se 5 m², per sa me siper te paraqitet:

- licence nga QKL me kodin II.1.B,
- akt-miratim higjeno sanitar,
- certifikata e mbrojtjes nga zjarri
- raport analizen e ujit te rrjetit,
- certifikaten e dezinfektimit 3D
- foto te ambjenteve te ushtrimit te aktivitetit.
- deklarate nga ana e operatorit ekonomik qe ambjenti i disponuar prej tij eshte me sip totale minimalisht 50 m² dhe ku ambjenti frigoriferik eshte jo me pak se 5 m².

Argumentimi: Kjo kerkesë është bazuar ne natyrën e kontratës së furnizimit, i cili është furnizim i përditshëm dhe për një afat 12.- mujor duke krijuar kështu nevojën për një ambient për magazinimin e produkteve. Kjo kërkesë është e domosdoshme dhe krijon kushte të favorshme dhe praktike për një furnizim sa më të shpejt në kohë dhe me kosto më të ulët për operatorin ekonomik. Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

2- Furre buke në pronësi ose në përdorim ose me kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me leje higjeno sanitare, license QKL me kodin II.1.A.(1), certifikaten e dezinfektimit 3D, certifikaten e mbrojtjes nga zjarri. Per produktin e mesiperm ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi me nje subjekt prodhues e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

3- Njësi prodhimi bulmeti ne pronesi ose perdorim ose me kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (per trajtimin dhe perpunimin e qumeshtit), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B. Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

4- Thertore ne pronesi ose perdorim ose me kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me: leje higjeno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore). Per thertoren te paraqitet vertetim nga AKU qe thertorja eshte funksionale (ne kuader te nismave qeveritare ne kete fushë). Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

5- Kompleks stallor ne pronesi ose perdorim ose me kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me Leje mjedisore me kodin III.1.B (mbareshtim kafshesh), License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.3.C. Per kompleksin stallor ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

6- Kompleks pularie ne pronesi ose perdorim ose me kontrate furnizimi sipas kontratës noteriale për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, te pajisur me, License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, amballazhim, etiketim e shperndarje me shumice e vezeve), II.1.B (shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez [veze]). Per kompleksin e pularise ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me kontrate furnizimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Argumentimi:Me anë të ketyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet e nevojshme. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, germa ç, pika 6 germa C dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

7- Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti, nga te cilat 1 (nje) frigoriferike ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronesie ose kontrate qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikate transporti (te paraqitet automjet i cili pajiset me kete certifikate sipas legjislacionit ne fuqi), lejen higjeno-sanitare, librezat shendetesore si dhe lejet e drejtimit te drejtuesve te mjeteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Automjeti nevojitet për transportin brenda normave higjeno-sanitare të lejuara të produkteve ushqimore objekt i kontratës

Disponimi i automjeteve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

NJESIA E PROKURIMIT